

RAPORT MONITORIMI I POLITIKËS

Parandalimi i
Konflikteve
Ndërmjet
Nxënësve në
Arsimin Para-
Univeristar

Komuna e Dardanës

Autore: Lejla Leci

Rishikues: KYC Kosova

Dizajni: Sh.P.K. "SUKI"

"Social Urban Innovation Kosova"

Të drejtat e autorit © 2025. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

Parandalimi i Konfliktëve Ndërmjet Nxënësve në Arsimin Para-Universitar

Rasti Shembull - Komuna e Dardanës



Ky raport u realizua me mbështetjen financiare të Unicef Kosovo Programme, IOM Kosovo dhe Peacebuilding Fund, si produkt i iniciativës së implementuar nga KYC Kosova dhe Këshilli i Nxënësve të Kamenicës.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

Hyrje

Shkolla është e obliguar që nxënësve t'u garantojë siguri të plotë dhe një ambient të përshtatshëm për mësim dhe zhvillim. Megjithatë, përmbushja e këtij obligimi shpesh herë rrezikohet nga faktorë të ndryshëm, si konfliktet mes nxënësve të së njëjtës shkollë, tensionet me nxënës të shkollave të tjera, apo edhe ndërhyrjet nga huliganë ose persona të rritur jashtë sistemit arsimor.

Ky fenomen i zakonshëm mund të ndikojë negativisht në procesin edukativo-arsimor dhe në mirëqenien e përgjithshme të nxënësve. Shkollat janë vendi ku nxënësit formojnë identitetin e tyre social, dhe nëse nuk ka mekanizma të përshtatshëm për parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve, mund të ketë pasoja të shumta si ulja e motivimit për të mësuar, përjashtimi social, rritja e dhunës dhe ndikimi në shëndetin mendor të nxënësve.

Ky raport ka për qëllim të monitorojë nivelin e zbatimit të politikave ekzistuese për parandalimin e konflikteve në shkollat e Komunës së Kamenicës. Ai ofron një pasqyrë të situatës aktuale, analizon boshllëqet dhe praktikrat e mira dhe paraqet rekomandime për përmirësim.

Metodologjia

Monitorimi u zhvillua duke përdorur një qasje të kombinuar të hulumtimit të dokumenteve dhe intervistave me palë kyçe. Metodatat e përdorura përfshijnë:

Hulumtimi i dokumenteve zyrtare (Desk Research): Për të kuptuar kuadrin ligjor dhe strategjik mbi parandalimin e konflikteve, u analizuan dokumentet kryesore si:

- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës
- Rregullorja QRK-Nr. 21/2013 për Parandalimin e Dhunës në Institucionet Arsimore
- Doracaku për Parandalimin e Dukurive Negative në Shkolla të Mesme të Larta
- Strategjia e Arsimit 2022-2026
- Statistikat në Arsim (2022-2023 dhe 2023 – 2024)
- Doracaku për parandalimin e dukurive negative në shkolla të mesme të mesme të larta
- Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës
- Udhëzimi Administrativ NR.6_2014 Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta
- Plani i veprimit për siguri në shkolla 2023-26 (Komuna e Prishtinës)

Intervista me palë kyçe: U zhvilluan intervista të strukturuar me:

- Nxënës, për të marrë perceptimet e tyre mbi konfliktet në shkollë dhe mënyrën si trajtohen ato.
- Drejtorë të shkollave për të kuptuar politikatat aktuale dhe sfidat që hasen në zbatimin e tyre.
- Mësimdhënës dhe psikologë shkollorë për të analizuar përvojat e tyre në menaxhimin e konflikteve dhe mbështetjen ndaj nxënësve.
- Zyrtarë të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), për të vlerësuar politikatat dhe mbështetjen institucionale.

Analiza e Politikave Ekzistuese dhe Zbatimi në Praktikë

Politikat dhe dokumentet strategjike të Kosovës përmbajnë udhëzime deri diku të qarta për parandalimin e konflikteve dhe dhunës në shkolla. Megjithatë, ka mangësi dhe në praktikë, zbatimi i tyre është i kufizuar për shkak të mungesës së burimeve të nevojshme dhe mungesës së trajnimit të stafit shkollor.

Rregullorja QRK-Nr. 21/2013: Ky dokument synon të parandalojë dhe trajtojë dhunën në institucionet arsimore para-universitare në Kosovë duke krijuar një sistem të rrjeteve mbrojtëse të brendshme dhe të jashtme në bashkëpunim me shkollën, DKA-të, MASHT-in, QPS, Policinë e Kosovës, dhe institucionet shëndetësore. Në praktikë ky bashkëpunim shpesh mungon, duke bërë që rastet e dhunës të mos trajtohen siç duhet. Gjithashtu, rregullorja nuk specifikon qartë se çfarë masash ndëshkimore do të merren ndaj nxënësve ose stafi të që shkaktojnë dhunë në shkollë.

Doracaku për parandalimin e dukurive negative në shkolla është një udhëzues praktik për mësimdhënësit, por përdorimi i tij mbetet i kufizuar për shkak të mungesës së njohurive mbi përmbajtjen dhe mungesës së trajnimeve të rregullta për mësimdhënësit për të inkorporuar të njëjtat në procesin mësimor.

Strategjia e Arsimit 2022-2026 synon sigurimin e mjediseve shkollore të sigurta, të shëndetshme dhe të përshtatshme, duke përfshirë infrastrukturën, pajisjet adekuate, hapësirat rekreative dhe laboratorike, si dhe mekanizmat për promovimin e shëndetit dhe sigurisë. Ajo thekson nevojën për masa parandaluese kundër dhunës, bullizmit, ekstremizmit dhe për edukimin shëndetësor, por këto aktivitete rrallë organizohen brenda shkollave dhe zakonisht realizohen nga OJQ-të ose akterë të jashtëm. Kjo strategji gjithashtu nuk përmban masa të detajuara për parandalimin e konflikteve ndërmjet nxënësve.

Udhëzimi Administrativ NR.6_2014 kërkon që shkollat të kenë rregullore të qarta për sjelljen e nxënësve, duke përfshirë respektin ndaj mësimdhënësesve, nxënësve të tjerë dhe pronës së shkollës. Megjithatë, shumica e shkollave nuk e kanë të përpiluar këtë rregullore.

Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës vendos ndër të tjerash edhe bazat për edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në sistemin arsimor, duke përfshirë rishikimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore për të shmangur stereotipat negative, paragjykimet dhe praktikat e dëmshme. Ndërsa ligji kërkon harmonizimin e teksteve shkollore, ky proces shpesh vonohet dhe nuk ka mekanizma të qartë për monitorim të rregullt. Në disa materiale mësimore ende hasen paragjyime gjinore, etnike dhe kulturore, duke kontribuar në nxitjen e diskriminimit dhe urrejtjes. Nuk ka programe të mjaftueshme për ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve mbi mbrojtjen e fëmijës dhe qasjen gjithëpërfshirëse në edukim.

Monitorimi zbuloi se:

- Në shumicën e shkollave, incidentet e vogla mes nxënësve nuk raportohen zyrtarisht dhe nuk trajtohen përmes mekanizmave formalë.
- Mësimdhënësit dhe stafi shkollor shpesh nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi teknikat e ndërmjetësimit dhe menaxhimit të konflikteve.
- Psikologët dhe këshilltarët janë të mbingarkuar dhe nuk mund të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për të gjithë nxënësit në nevojë.
- Nxënësit raportuan se shpesh ndihen të pambrojtur ose të keqkuptuar nga autoritetet shkollore kur raportojnë konflikte ose dhunë.
- Mungesa e rregulloreve dhe komisioneve disiplinore që trajtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë parandalimin dhe menaxhimin e dhunës në shkolla.
- Ligjet dhe dokumentet aktuale nuk adresojnë në mënyrë të detajuar çështje thelbësore si rrethojat e objekteve shkollore, pajisja me kamera të sigurisë, daljet emergjente, pjerrinat dhe akomodimi për personat me aftësi të kufizuara.
- Në shkollat e Kamenicës shpesh ka policë që patrollojnë pranë shkollave për të ndërhyrë shpejt në rastet e dhunës apo incidenteve të tjera. Megjithatë, sipas komenteve të nxënësve, ata shpesh i njohin policët edhe kur janë me rroba civile dhe tregohen më të kujdesshëm në praninë e tyre. Kjo tregon se prania e policisë mund të ketë një efekt parandalues, por gjithashtu sugjeron nevojën për strategji të tjera mbikëqyrjeje dhe ndërhyrjeje për të adresuar dhunën në mënyrë më efektive.

Rekomandime nga Monitorimi i Politikave Arsimore

Bazuar në gjetjet kryesore të monitorimit, rekomandohen hapat e mëposhtëm për të përmirësuar zbatimin e politikave në shkolla:

Forcimi i mekanizmave të disiplinës dhe sigurisë në shkolla

- Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve të brendshme në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Kodin e Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore.
- Krijimi dhe funksionalizimi i Komisioneve Disiplinore në çdo shkollë, të cilat të trajtojnë në mënyrë të drejtë dhe efi kase rastet e shkeljeve të disiplinës dhe dhunës.
- Trajnimi i mësimdhënësve dhe stafi t shkollor për menaxhimin e konflikteve dhe parandalimin e dhunës mes nxënësve.
- Hartimi i Strategjive dhe Planeve të Veprimit (si shembull Plani i veprimit për siguri në shkolla 2023-26 nga Komuna e Prishtinës)

Fuqizimi i Këshillave Drejtues të Shkollave dhe zinxhirit të vendimmarrjes

- Sigurimi i funksionimit efektiv të Këshillave Drejtues duke përfshirë përfaqësues të prindërve, nxënësve dhe komunitetit.
- Rritja e transparencës në proceset vendimmarrëse përmes takimeve të rregullta dhe raporteve publike mbi menaxhimin e shkollës.
- Mbikëqyrje e rreptë nga institucionet arsimore për të siguruar zbatimin e rregullave dhe vendimeve të marra nga Këshilli Drejtues.

Përmirësimi i kurrikulës dhe edukimit mbi mbrojtjen e fëmijëve




- Rishikimi i teksteve shkollore për të eliminuar gjuhën që mund të nxisë ndasi, diskriminim ose stereotipe.
- Integrimi i temave mbi mbrojtjen e fëmijës, sigurinë dhe sjelljet etike në mësimdhënie, duke përfshirë edukimin për të drejtat e njeriut, parandalimin e bullizmit dhe konflikteve fi zike.
- Ofrimi i trajnimeve për prindërit dhe mësuesit mbi format jo të dhunshme të disiplinimit dhe teknikat e menaxhimit të sjelljes së nxënësve.

Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitutional për sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve

- Krijimi i një zinxhiri të qartë bashkëpunimi mes shkollës dhe institucioneve relevante si Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), Qendra për Punë Sociale (QPS), Policia, MASHT, Ministria e Shëndetësisë dhe organizata të tjera të specializuara.
- Emërimi i një personi të dedikuar brenda QPS i cili do të merret ekskluzivisht me çështjet e nxënësve dhe rastet problematike në shkolla, duke siguruar reagim të shpejtë dhe efikas.

Përmirësimi i sistemit të monitorimit në shkolla

- Edhe pse në shumicën e shkollave janë të instaluar kamera sigurie, ato shpesh nuk mbulojnë të gjitha zonat e institucionit, duke lënë hapësira të pambikëqyrura ku mund të ndodhin incidente. Për më tepër, cilësia e pamjeve është shpesh e dobët, duke e bërë të vështirë identifi kimin e nxënësve të përfshirë në raste problematike. Rekomandohet investimi në pajisje më cilësore dhe rishikimi i vendosjes së kamerave për të mbuluar të gjitha zonat kritike të shkollës.



Prishtinë, 2025